

HYLLI I DRITËS

Ubi Spiritus Domini, ibi libertas.
(II. ad Cor. III. 17).

VOTER
KULTURE
SHQYPTARE

8-10

Gusht-Tetuer 1939 - XVII.

VJETI XV.

S H K O D E R

369

Abonimi per „HYLLI I DRITËS“

Shqypni	Nji numer Fr. a. 0.80	Nji vjetë Fr. a. 7.—
Itali	„ „ „ „ 0.80	„ „ „ „ 7.—
Nder Vende tjera . .	„ „ „ „ 1.20	„ „ „ „ 10.—

Administratori: A. B. Dema

HYLLI I DRITËS

PERMBAJTJA

Drejtësia nderkombtare	fq. 369
BARDHYLI	
Mark Mboçari	» 37
Prej tetratyres botnore: « Vaji i Hildegundës » (vjerrsha)	» 38
SPIRO KONDA	
Kritoni i Platonit	» 400
GELASIUS	
Fjalori toponomastik: Emna vendesh	» 408
GJETO KOLA	
Himara	» 417
Prof. FRANO ALKAJ	
Iliada e Homerit (Libri XXIV)	» 432
ADOLPHE FERRIÈRE	
Bakule e vepra e tij edukatore	» 429
BARDHYLI	
Historija e Bibliotekavet në Shqiprië: Bibliotekat e Bibliotektarët	» 438
D. N. KIMEZA	
Cika e pyetje historike	» 44

(vijon në fq. 3 të mblojcës)

DREJTSIJA NDERKOMBtare

S — Ku ká drejtsí, s'ka luftë. Paqja e drejtsija shkuen gjithmonë krahas e doradoras si dý motra të padashme, si thote edhë ajo shkrola e vjeter: *Justitia et pax osculatae sunt*.

Të verteten e ksajë fjale jo vetem krént e bajraktarët e popujvet barbarë, por duket se e ndiejn edhë vetë atà do presidenta e kryeministra Shtetensh kshtu të quejtun të gjytetnuem t' Europës e t' Amerikës; pse tash nji vjetë — elë mâ tash gjashtë muej e tektej s' âsht ndie në gojë të tyne fjalë tjetër mâ shpesh se fjala «drejtsí». Njimend, gjatë ksajë kohe s' ké hapë fletore, s' të ká rá me ndie «radio» qi mos të keshë lexue a mos t' i ketë bâ me tingllue veshët njani a tjetri ksi presidentash a kryeministrash t' Europës a t' Amerikës, se aj e Shteti i tij gjithmonë janë mundue e se gjithmonë edhë do të mundohen me ruejt paqjen, tue sundue me drejtsí, e tue matë e tue pré, e gjithshkafen tue e peshue m' kandarë të drejtsís, si per vedi ashtu per tjerë.

Mirë po, me gjith kso fjalësh së mdhá paqi e prejt-sije, sod plasi lufta; e disá nder ksi së të qujtunsh popuj të gjytetnuem i a kan nisë e po i a derdhin shoqishoqit trût nper ajr, nper tokë e dét: e kta me nji egercí qi me shtangue m' kamë vetë Otentott e Kanibalt prej hatajet. E pra sugurisht, se kû ká drejtsí, s'ká luftë. Si mundet prandej me kënë, qi me gjith drejtsí, mbí të cillen thonë se pshteten kta do kryetarë qeverish n' Europë e n' Amerikë, sod pelset lufta, e gjaku i nierit po mund të rrmejë shkulma shkulma, e po të rrenohet shka mâ të marë e mâ të mirë pat kavatue mendja e dora e nierit? Per me mâjtë e me i pergjegjë me rend e me vend ksajë pvetje, nji herë mâ para ktu dubet me dijtë, palë se ç' kuptim i apin kta kryetarë të kshtu të

